

Nr. 503 prot.

Nr. 104 prot.

Tiranë, më 27.03.2024

Tiranë, më 27. 3.2024

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, më datë 27.03. 2024, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

**1. Kolegji Universitar BEDËR**, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Gjergji Sinani, Rektor i Kolegjit Universitar Bedër.

dhe

**2. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)**, përfaqësuar nga Znj. Gentiana Sula, Kryetarja e Autoritetit,

Palët janë marrë vesh se për të realizuar qëllimin e përbashkët do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje të shprehura më poshtë.

#### NENI 1 Qëllimi i marrëveshjes

##### Qëllimi

1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Kolegji Universitar Bedër, hartojnë këtë marrëveshje me qëllim te informimit dhe të ndërgjegjësimit të shoqërisë sonë, lidhur me periuðhën e errët të krimeve të komunizmit të kryera nga strukturat e ish-sigurimit të Shtetit mbi persekutimin e disa figurave të klerikëve myslimanë (sunitë dhe bektashi). Të nxisim dhe të promovojnë së bashku punën kërkimore-shkencore, dhe të mendimit analistik në funksion të demokracisë permes kulturës së imazhit. Të rrisim interesimin e kuptimit publik e në mënyrë të veçantë tek brezat e rinj njojhen më të mirë të së kaluarës por dhe të funksioneve të institucioneve demokratike dhe atyre arsimore në kuadër të zbatimit të legjislacionit të tanishëm në fuqi.
2. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në njojjen e së shkuarës, nëpërmjet hapësirave e mundësive për ballafaqim me dosjet dhe historitë e komunizmit, për edukimin e brezave të rinj dhe zhvillimin e dialogut të shëndetshëm shoqëror, në emër të një të ardhmeje më të mirë.

## **NENI 2**

### **Objekti i marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka si objekt bashkëpunimin midis dy institucioneve të lartpërmendura. Fushat e veçanta të bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit Universitar Bedër dhe Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në pikë të mëposhtme:
  - Sigurimi i variantit digital të dosjeve të personaliteteve dhe Klerit Mysliman në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
  - Studimi i dosjeve të siguruara nga kjo marrëveshje dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta në këtë fushë, si leksione, seminare, takime akademike dhe forume;
  - Trajnine dhe shkëmbime të eksperiencave ndërmjet stafit;
  - Praktika mësimore;
2. Kolegji Universitar Bedër duhet të sigurojë për kërkuesit Autorizimin përkatës për lejimin për kërkim në dokumentacionin arkivor nga Komuniteti Mysliman Shqiptar sipas kërkesës për klerikët që do të bëhet nga çdo studiues i KU Bedër. (sipas pikës 3.1. Kërkesat për qëllime kërkimore dhe historike të Udhëzuesit “Për aksesin dhe Përdorimin e Arkivit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për Institucionet të kërkimit Shkencor, gazetarë, media dhe studiues”).
3. Bashkëpunimi në fushën e materialeve digitale, rubrikave mediatike, online, videove sensibilizuese, dëshmive gojore, të botimeve, etj., mbi kujtesën kolektive dhe ndërgjegjësimin për të shkuarën, që hedhin dritë në krimet e diktaturës dhe periudhën kur ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit.

## **NENI 3**

### **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj Marrëveshjeje; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Neni 60; Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar; Nenet 36, 37, 38 të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzues “Për aksesin dhe Përdorimin e Arkivit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për Institucionet të kërkimit Shkencor, gazetarë, media dhe studiues”; Rregullore e AIDSSH “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit; VKM nr. 93, datë 27.02.2019, “Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Rezoluta nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) të Kuvendit të Shqipërisë, Rezoluta e Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019) dhe parimet e Rrjetit Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit.

Urdhri i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 247, datë 28.07.2017 “Për miratimin e tarifave të njësuara të shërbimit të dokumentacionit në rrjetin arkivor kombëtar të Republikës së Shqipërisë”, pika 1 (lidhja 1, kreu IV/2 përjashtime).

## **NENI 4**

### **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

Në përbushje të kësaj marrëveshjeje Kolegji Universitar Bedër dhe AIDSSH kanë të drejta dhe detyrime, dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të misioneve të tyre, si më poshtë:

- a) Palët marrin përsipër që të mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave midis stafeve respektivë, duke organizuar aktivitete të tilla, si seminare, konferanca etj. Palët do të merren vesh paraprakisht për zhvillimin e këtyre aktivitetave.
- b) Autoriteti merr përsipër të angazhojë stafin e propozuar nga KU Bedër, i cili do të ketë lehtësirat dhe hapësirat e nevojshme për nxjerrjen dhe sigurimin e variantit digjital të dosjeve të personaliteteve dhe Klerit të Komunitetit Mysliman dhe Bektashian në ambientet e AIDSSH.
- c) Në bazë të nevojave të AIDSSH dhe brenda kapaciteteve të tij, KU Bedër do të ofrojë trajnime profesionale për stafin e Autoritetit. Kushtet mbi planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e këtyre trajnimeve do të përcaktohen nga palët, rast pas rasti.
- d) Palët bashkëpunojnë në pjesëmarrjen me analiza, punime të përbashkëta në projekte kërkimore të organizuara në bashkëpunimin ndërmjet KU Bedër dhe AIDSSH.
- e) Autoriteti angazhohet të japë informacione dhe orientime studentëve të KU Bedër gjatë procesit të hartimit të tezave të diplomës dhe të disertacioneve që lidhen me veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- ë) Autoriteti merr përsipër të angazhojë persona të caktuar nga stafi i tij në projekte kërkimore të organizuara nga KU Bedër.
- f) Palët do të bashkëpunojnë në organizimin e konferencave, seminareve dhe veprimitarive të përbashkëta kulturore e kinematografike të këtij lloji për çështje të tjera me interes publik dhe që përfshihen në objektin e kësaj marrëveshjeje;
- g) Palët angazhohen në ndihmën e ndërsjelltë dhe mbështetje teknike dhe profesionale në organizimin e workshop-eve profesionale dhe konferencave që do të zhvillohen në të ardhmen në ambienetet e KU Bedër ose në ambienetet e AIDSSH.

## **NENI 5** **Pronësia intelektuale**

Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dokumentacion arkivor, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës, e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në pronësi të përbashkët të të dyja palëve.

Palët i jepin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të seilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe planeve vjetore të shkëmbyera reciprokisht për periudhën e kohës gjatë së cilës zgjat marrëveshja.

## **NENI 6** **Bashkëpunime midis dy institucioneve**

Marrëveshja krijon bashkëpunim në nivele institucionale dhe të kërkimit, lehtëson aksesin në dokumentacionin dhe në aktivitete të përbashkëta, në rastin e organizimeve studimore apo botimeve dokumentare që lidhen me dokumentacionin historik të shtetit shqiptar, si dhe krijon bazën e bashkëpunimit midis stafeve, duke përfshirë punonjësit dhe kërkuesit shkencorë të dy institucioneve në projekte e aktivitete të përbashkëta që lidhen me fokusin e tyre.

## **NENI 7** **Bashkëpunimi në fusha të tjera**

Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Kolegji Universitar Bedër janë të gatshëm të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat për të cilat shfaqin interes të përbashkët dhe bien dakord.

a) Në bazë të nevojave të Kolegit Universitar Bedër dhe brenda kapaciteteve të saj, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të ofrojë mundësi për zhvillimin e praktikave mësimore për studentët e Kolegit Universitar Bedër. Kushtet për zhvillimin e praktikave mësimore do të përcaktohen me marrëveshje të palëve.

a) Kolegji Universitar Bedër, në bazë të kërkesave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, do të ofrojë mundësi bursash studimi për anëtarët e stafit të institucionit në fjalë, në programet Master, për çdo vit akademik. Bursa e studimit përfshin shpenzimet në lidhje me aktivitetin mësimor.

**NENI 8**  
**Afati i Marrëveshjes**

1. Marrëveshja ka kohëzgjatje 3 (tre) vjeçare. Marrëveshja mund të ripërtërihet me dakortësinë e palëve për një periudhë tjeter 2 (dy) vjeçare pas përfundimit të afatit 3 (tre) vjeçar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjeter, (të paktën një muaj përparr).
3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacioneve të shkëmbyera përparrat datës së përfundimit të saj.

**NENI 9**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozithohen në **Kolegin Universitar Bedër** dhe dy të tjera depozithohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit**.

**PËR**

**KOLEGJIN UNIVERSITAR BEDËR**

Prof. Dr. Gjergj Sinani



**PËR**

**AUTORITETIN PËR  
INFORMIMI MBI  
DOKUMENTET E ISH-  
SIGURIMIT TË SHTETIT**

Znj. Gentiana Sula

Gentiana Sula

